

UNMIK/DIR 2000/06  
12 prill 20000

---

**URDHËRESA ADMINISTRATIVE NR. 2000/06**

**ZBATIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR.2000/20 MBI ADMINISTRATËN  
DHE PROCEDURAT TATIMORE TË DATËS 12 PRILL 2000**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet e dhëna atij me Rregulloren nr. 2000/20 të UNMIK-ut, të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore,

Shpall këtë urdhëresë administrative:

Neni 1  
Kamatat

Administrata tatimore mund të kërkojë kamatë për pagesat e vonuara të tatimit, në pajtim me tarifat e huasë komerciale në Kosovë, siç ka njohtuar publikisht kohë pas kohe Organi Qendror Fiskal,

Neni 2  
Mbledhja e dhunshme e tatimit

2.1 Varësisht nga procedurat e ankesës të përfshira në nenin 7 të Rregullores nr. 2000/20, të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore, kur tatimpaguesi nuk e ka paguar tatimin e vlerësuar në pajtim me njoftim-vlerësimin dhe kërkesën për pagesë të lëshuar nga administrata tatimore, administrata tatimore mund:

- (a) të ofrojë njoftim të vazhdueshëm për pagimin e tatimit me force:
  - (i) personave që janë të obliguar t'i paguajnë taksapaguesit pagën apo rrogën;
  - (ii) çdo banke ose institucioni kreditues financiar që mban fondet e tatimpaguesit; ose/apo

(iii) çdo personi tjetër fizik apo juridik ose ndërmarrës individual që i ka borxh taksapaguesit.

(b) t'ia kufizojë tatimpaguesit të drejtën mbi pasurinë, qoftë ajo e luajtshme apo e pa luajtshme. Kufizimi i të drejtave të tatimpaguesit në një pasuri të caktuar do të thotë se taksapaguesi mund ta përdorë pasurinë nën mbikqyrjen administrates tatimore, por nuk mund ta shpronësojë atë. Kufizimi i të drejtave të taksapaguesit në pasuri do të shërbejë poashtu si njohtim për qëllimin e administrates tatimore për t'ia marrë pasurinë e kufizuar dhe

c) t'ia konfiskojë pasurinë taksapaguesit, pa marrë parasysh se a është njoftuar tatimpaguesi për këtë qëllim apo jo.

2.2 Varësisht nga procedurat e ankesës, të përfshira në nenin 7 të Rregullores nr. 2000/20, të datës 12 prill 2000 mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore, Administrimi i Taksave mundet, në pajtim me procedurat e parashtruara në udhëzimet administrative të lëshuara nga bashkëdrejtuesit e Organit Qendror Fiskal, të shes në ankand publik çfarëdo pasurie të taksapaguesit që është konfiskuar në mënyrë të ligjshme.

2.3 Bashkëdrejtuesit e Organit Qendror Fiskal nxjerrin udhëzime administrative përmes të cilave përcaktohen procedurat për tatimin e detyrueshëm, konfiskimet dhe kufizimet e të drejtave të taksapaguesit mbi pronën dhe lirin e konfiskimeve, kufizimeve apo tatimeve të tilla.

### Neni 3 Përfshirjet

Format e mëposhtme të pasurisë së taksapaguesit përfshihen nga tatimi, kufizimi apo konfiskimi:

- (a) pagesat për përkujdesjen e fëmijës dhe ndihma sociale;
- (b) veshmbathja e domosdoshme;
- (c) ushqimi themelor;
- (ç) orenditë themelore;
- (d) gjërat personale themelore, duke përfshirë sendet luksoze;
- (e) veglat e zanatit të taksapaguesit dhe
- (f) çfarëdo pasurie tjetër e përcaktuar në udhëzimet administrative të lëshuara nga bashkëdrejtuesi i Autoritetit Qendror Fiskal.

Neni 4  
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi më 12 prill 2000.

Bernard Kouchner  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

## UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2000/7

### ZBATIM I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2000/20 MBI ADMINISTRIMIN E TAKSAVE DHE PROCEDURAT, E DATËS 12 PRILL 2000

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet e dhëna atij me nenin 7 të Rregullores nr. 2000/20 të UNMIK-ut, të datës 12 prill 2000, mbi Administrimin e Taksave dhe Procedurat,

Shpall udhëzimin administrativ në vijim:

#### Neni 1

#### Themelimi i bordit të pavarur për rishqyrtim

- 1.1 Bordi i pavarur i rishqyrtimit (këtu e tutje "bordi"), me këtë, themelohet për të pranuar dhe dëgjuar ankesat e taksapaguesve në lidhje me vendimet përfundimtare të marra nga Administrimi i Taksave/Administrata e Taksave.
- 1.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë tre anëtarë për të punuar në Bord. Anëtarët do të jenë të pavarur nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe do të përfshijnë/nkuadrojnë një përfaqësues nga bashkësia e biznesit e Kosovës.
- 1.3 Për emërimin e parë të anëtarëve pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, një anëtar do të emërohet për një afat njëvjeçar dhe dy anëtarë do të emërohen, secili, për një afat prej dy vitesh. Së këndejmi, emërimi i të gjithë anëtarëve mund të përtëritet për afatet e mëtejme dyvjeçare.
- 1.4 Në rast të papërshtatshmërisë për të punuar, paaftësisë, vdekjes apo dorëheqjes së një anëtari, që ndodh gjatë afatit/mandatit të emërimit, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë një anëtar tjetër. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të marrë vendimin përfundimtar për të emëruar apo shkarkuar anëtarët nga Bordi.

- 1.5 Bordi do të punësojë personel profesional kompetent dhe do të vendos për rregullat e veta të procedurës, duke përfshirë kushtet, në të cilat taksapaguesit mund t'i ofrohet një afat më i gjatë kohe brenda të cilit të paraqesin kërkesat e tyre.

## Neni 2

### Ankesat për Bordin e pavarur të rishqyrtimit

- 2.1 Taksapaguesi, i cili ka pranuar vendimin përfundimtar nga Sektori për Ankesa i Administrimit të Taksave, mund t'i ankohet bordit për një rishikim të vendimit.

2.2 Ankesa nga taksapaguesi për/tek Bordin duhet të bëhet në pajtim me nenin 7 të Rregullores nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administrimin e Taksave dhe Procedurave dhe në pajtim me rregullat dhe procedurat e pëcaktuara nga Bordi.

2.2 Ankesa e taksapaguesit në Bord duhet të bëhet pa pagesë.

## Neni 3

### Funksionet e Bordit të pavarur të rishqyrtimit

- 3.1 Bordi do të udhëheq seancën e shqyrtimit dhe do të rishikoj dëshmitë relevante/përkatëse, dokumentet dhe dëshmitë e tjera të paraqitura nga taksapaguesi dhe Administrimi i Taksave/administrata e taksave.
- 3.2 Bordi do ta diskutojë rastin në formë jurie dhe duhet t'i njohtë palët për vendimet e tij, shoqëruar nga arsyet e dhëna me shkrim për vendimin e marrë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh pas përmbylljes së seancës së shqyrtimit. Vendimi i Bordit mirret mbi bazën e shumicës.
- 3.3 Vendimi i Bordit është obligativ si për taksapaguesin, ashtu edhe Administrimin e Taksave, pos nëse nuk ndryshohet ose kthehet prapa / shfuqizohet nga ana e gjyqit.

## Neni 4

### Konfidencialiteti i informatave të taksapaguesit

Anëtarët e Bordit duhet të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve të taksapaguesit dhe të dhënat e siguruar, madje edhe pas përfundimit të afatit të emërimit të tyre.

## Neni 5

### Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi më 12 prill 2000.

Bernard Kouchner  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm